



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA E APELIT
VLORË

Nr. 2381 Regjistri Themeltar
Nr. 1111 Vendimi



VENDIM
“NE EMER TE REPUBLIKES”

Gjykata e Apelit Vlorë e përbërë prej:

KRYESUES: Andi CIVICI
ANËTAR: Hysen SALIKO
ANËTARE: Klodiana GJYZARI


Asistuar prej sekretares **Rozeta Hoxhaj**, në Vlorë sot në datë 13.10.2015, mori në shqyrtim në séancë gjyqësore në shkallë të dytë çështjen civile që i përket:

KERKUES: Shpresa Mucaj, (ne mungese).

PERSON I TRETË: Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqerore Fier, (ne mungese).

OBJEKTI: Vertetimin e faktit juridik te qenies ne marredhenie pune te prane ish-Kooperatives Bujqesore Hekal per periudhen nga data 01.07.1972 deri me date 31.12.1978, duke realizuar per cdo vit minimumin e diteve te punes qe planifikonte Kooperativa per grate.

Baza ligjore: Neni 388 i Kodit te Procedures Civile.



Gjykata e Rrethit Gjyqësor Fier, me vendimin Nr.428 datë 03.04.2014 ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës;

R



RR 128 571 164 AA

- Vërtetimin e faktit juridik të qënies në marrëdhënie pune të kërkueses Shpresa Muçaj në ish-Kooperativën Bujqësore Hekal për periudhën nga data 01.07.1972 deri më date 31.12.1978, duke përcaktuar për çdo vit pune minimumin e ditëve të punës që planifikonte Kooperativa për gratë.
- Shpenzimet gjyqësore i ngarkohen kërkueses.

Kundër këtij vendimi, ka paraqitur ankim pala e paditur, ne te cilin parashtron shkaqet për ndryshimin e tij:

- Gjykata ka gabuar ne dhenien e vendimit, pasi nuk jemi ne kushtet e vertetimit te faktit juridik sepse kerkuesja figuron ne rregjistrat e ish-Kooperatives Bujqesore Hekalper periudhen nga viti 1979 deri ne vitin 1990, por per periudhen nga viti 1972 deri me 1978 nuk rezelton te kete punuar.
- Ky vertetim fakti u be duke u bazuar vetem ne theniet e deshmitareve dhe pa u paraqitur asnje prove shkresore nga kerkuesja.
- Per sa siper kerkojme ndryshimin e vendimit, dhe rrezimin e kerkese padise.

GJYKATA E APELIT VLORE

Pasi degjoi relatorin e çështjes Andi Civici, dhe pasi e bisedoi ne teresi ceshtje, ne mungese te paleve ndergjyqesa;

V E R E N

Vendimi i Gjykates se shkalles se pare Fier Nr.428 datë 03.04.2014 me te cilin eshte vendosur pranimi i kerkes se kerkueses, eshte i drejte, i bazuar ne prova e ne ligj dhe si i tille duhet te lihet ne fuqi.

Ka rezultuar nga gjykimi ne shkalle te pare se:

Kërkuësja Shpresa Muçaj ka lindur në Belishovë dhe ka lidhur martesë ligjore me shtetasin Refat Muçaj në datën 30.05.1972.

Sipas pretendimeve të kërkueses rezulton se ajo ka punuar në ish-Kooperativen Bujqësore Cakran nga viti 1968 deri sa është martuar më datë 30.05.1972 dhe pas

martesës nga data 01.07.1972 deri në vitin 1990 ka punuar në ish Kooperativën Bujqësore Hekal.

Faktin e qënies në marrëdhënie pune pranë ish-Kooperativës Bujqësore Hekal kërkuesja e ka të provuar për periudhën nga viti 1979 deri në vitin 1990, ndërsa për periudhën nga data 01.07.1972 deri më datë 31.12.1978, për shkak se dokumentacioni i kësaj ish-Kooperative, pjesërisht rregjistrat dhe listëpagesat janë djegur, e ka të pamundur të vërtetojë vjetërsinë në punë për këtë periudhë për efekt të përfitimit të pensionit.

Bazuar sa më sipër kërkuesja kërkon vërtetimin e faktit juridik të vjetërsisë në punë pranë ish-Kooperativës Bujqësore Hekal për periudhën 01.07.1972 deri në 31.12.1978.

Përfaqësuesi i personit të tretë kërkoi pranimin e kërkesës sipas objektit të saj.

Këtë kërkesë kërkuesja e mbështetet në nenin 388 të K.Pr.Civile.

Në nenin 388 të Kodit të Procedurës Civile përcaktohet se: kur nga një fakt varet lindja, ndryshimi ose shuarja e të drejtave personale apo pasurore të një personi dhe akti që vërteton atë është zhdukur, ka humbur dhe nuk mund të bëhet përsëri ose nuk mund të merret me ndonjë rrugë tjetër, personi i interesuar ka të drejtë të kërkojë që fakti të vërtetohet me vendim të gjykatës së shkallës së parë.

Gjykata me te drejte vlerëson se kërkesa është bazuar në ligj dhe në prova dhe si e tillë duhet të pranohet për sa më poshtë:

Nga vërtetimi nr.06 regj, datë 15.01.2014, lëshuar nga Komuna Hekal Mallakastër, rezultoi e provuar në gjykim se dokumentacioni i ish-Kooperativës Bujqësore Hekal është djegur pjesërisht në vitin 1997.

Sipas certifikatës së martesës me nr.003804502, datë 10.01.2014, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Rrethit Fier, rezulton i provuar fakti që paditësja është martuar me shtetasin Refat Muçaj në datën 30.05.1972. Nga certifikata familjare me nr.004571254, datë 08.01.2014, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Hekal rezulton se shtetasja Shpresa Muçaj është banore e kësaj komune.

Nga thëniet e dëshmitarëve Nexhdet Boraj dhe Behije Muçaj rezultoi se kërkuesja ka punuar në ish Kooperativën Bujqësore Hekal nga viti 1972 deri sa është shpërbërë kooperative.

Nga verifikimet e bëra nga personi i tretë rezulton se periudhën e saj të punësimit pranë ish kësaj Kooperative Bujqësore dëshmitarja Behije Kaso e ka të vërtetuar.

Nisur nga faktet e parashtruara më lart, Gjykata me te drejte krijon bindjen se kërkesa e kërkueses Shpresa Muçaj për vërtetimin e faktit juridik të qënies në marrëdhënie pune pranë ish Kooperativës Bujqësore Hekal për periudhën nga data 01.07.1972 deri më datë 31.12.1978 është e drejtë dhe si e tillë duhet pranuar.

Persa me siper Gjykata e Apelit e gjen te drejte vendimin e gjykates se shkalles se pare, te bazuar ne prova dhe ne ligj. Asnje prej shkaqeve te permendura ne ankim nuk e ben te cenueshem vendimin. Me te drejte kerkuesja ka investuar gjykatën nepermjet erkeses per vertetimin e faktit juridik dhe jo me padi sec pretendon ne ankim personi I trete. Sa me siper cmohet lenia ne fuqi e vendimit e ankimuar.

PËR KËTO ARSYE

Në mbështetje të nenit 466/a të K.Pr.Civile, Gjykata e Apelit Vlorë

V E N D O S I

Lenien ne fuqi te vendimit Nr. 428 datë 03.04.2014 te Gjykates se Rrethit Gjyqesor Fier.

Vlorë, më 13.10.2015

A N E T A R
Hysen SALIKO

A N E T A R E
Klodiana GJYZARI

K R Y E S U E S
Andi CIVICI

